



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709 / prot.

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr 48 datë 20.03.2025

Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe në programet e të ciklit të dytë Master profesional dhe Master i shkencave që do të zhvillohen në gjuhën angleze për vitin akademik 2025-2026

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në Vendimin nr.44, datë, 17.03.2025 të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", *Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe në programet e të ciklit të dytë Master profesional dhe Master i shkencave që do të zhvillohen në gjuhën angleze për vitin akademik 2025-2026* Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës03.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit ciklit të parë të studimeve Bachelor në programet e studimeve të ciklit të dytë që do të zhvillohen në gjuhën angleze, me kohë të plotë (Tabela 5 bashkëlidhur), **610 kuota** të ndarë si më poshtë vijon:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë shtetas të huaj: **610 kuota**.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian DURMISHI

